



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 16 , Datë 14.02.2024

MONITORIM I KYER NGA APP

Autoriteti kontraktor	MINISTRIA E DREJTËSISË
Hetim Administrativ, iniciuar nga	• APP X • Reklamim nga të tretë
Numri i kontratave	2 (dy)
Konstatimet kryesore	Gjatë hetimit administrativ, APP konstatoi se: 1. Plani i zbatimit të kontratës ka mangësi përsa i përket çështjeve organizative e teknike të kontratës, që lidhen me monitorimin e zbatimit të saj. 2. Procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit, objekt kontrate, nuk u provua se është i rregullt, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. 3. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me pikën 1, të nenit 124, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pikës 7, të nenit 107, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pasi për kontratat objekt hetimi, nuk ka administruar dhe verifikuar dokumentacionin e nevojshëm për të siguruar që malli i dorëzuar plotëson kërkesat e cilësisë sipas specifikimeve teknike, të parashikuara në dokumentet e tenderit.
Masat e marra	Në bazë të neneve 23, gërma “e”, dhe 132, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, APP vendosi të propozojë

dhënien e masës disiplinore ndaj 4 personave, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim dhe personave përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të kontratave, objekt hetimi, për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në vendim.